

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2016

RISQET BANKARE DHE KRIZA FINANCIARE

Vlora Rexhaj - Belallari

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

RISQET BANKARE DHE KRIZA FINANCIARE
Shkalla Bachelor

Vlora Rexhaj - Belallari

Shtator / 2016
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2013-2014

Vlora Rexhaj - Belallari

RISQET BANKARE DHE KRIZA FIANCIARE

Mentori: Prof. Dr. Bukurie Imeri-Isufi

Shtator / 2016

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesëshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Teza trajton risqet bankare dhe krizën ekonomike globale të viteve 2008-2011 duke nisur me përshkrimin dhe analizën e shkaqeve kryesore të saj si dhe debatet në lidhje me shkaktarët kryesorë të krizave. Krizat financiare dhe ekonomike nuk janë të panjohura për botën. Ato u paraqitën gati në mënyrë ciklike në periudha të ndryshme nëpër shekuj, duke tundur shumë herë edhe themelet e shteteve. Këto kriza u shfaqen nëpër të gjitha format e tyre: financiare, ekonomike, sociale...

Si pasojë e shkallës së lartë të integritit të sistemeve financiare në botë, kriza financiare u shpërnda shumë shpejtë edhe në vendet tjera. Evoluimi i shpejtë i krizës financiare si dhe rënia e besimit në tregun ndërbankar rezultoi në rënie të likuiditetit dhe rritje të normave të interesit në këtë treg ku, për shembull, Libor dhe Euribor shënuan një rritje të vazhdueshme. Për më tepër, financimi ndërbankar në afat më të gjatë pothuaj pushoi së ekzistuari. Si rezultat, një numër i konsiderueshëm i bankave u ndodh në vështirësi të mëdha financiare duke lëkundur besimin e përgjithshëm në tregje.

Brenda një kohe të shkurtër, problemet në sektorin financiar u reflektuan edhe në sektorin real të ekonomisë. Kjo ndodhi kryesisht përmes shtrëngimit të kredisë për biznese dhe ekonomi familjare duke shkaktuar ngadalësimin e aktivitetit ekonomik dhe duke krijuar pasiguri të lartë në tregjet e kapitalit. Ngadalësimi ekonomik në SHBA sjell uljen e importeve nga bota emergjente, që ndikon rëndë në ekonominë e tyre. Po ashtu, ky ngadalësim ndikon në papunësi, ulje të shitblerjeve, dëmtim të konfidencës së konsumatorëve, që në fund sjellin një ulje të nivelit të shpenzimeve në tregjet e përgjithshme dhe presion të drejtpërdrejtë në vlerën e aseteve të patundshme.

Kriza ndërkombëtare ka shfaqur efektet e saj në mbarë ekonominë globale. Kryesisht kjo krizë i ka dhënë këto efekte në aspektin financiar dhe për këtë arsye qëllimi i temës është që të jap disa mendime në lidhje me krizën ekonomiko – financiare, arsyet e kësaj krize dhe mënyrën e menaxhimit të saj.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Si fjalë e parë gjatë këtij punimi, falenderoj Zotin që më ka ndihmuar te arrij në këtë pikë të studimeve të mia dhe të kem rastin të punoj këtë punim diplome, më të cilin formalisht shënoj përfundimin e këtij cikli studimesh të nivelit bachelor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, Prishtinë. Falenderoj familjen time, bashkëshortin i cili ka qenë mbështetja primare e pa zëvendësueshme në çdo hap që kam hedhur si dhe fëmijët që më mirëkuptuan në çdo moment edhe pse shumë të vegjël duke ma bërë më të lehtë përfundimin e këtij punimi. Me zemër falenderoj prindërit dhe motrat sidomos Linën, që më kanë qëndruar afër dhe më kanë inkurajuar deri në përfundim të studimeve të mia.

Një falenderim tjetër për të gjithë stafin akademik të UBT - së e veqanërisht për udhëheqësen time phd. Bukurie Imeri-Isufi që me kontributin, profesionalizmin dhe përkushtimin e saj më ka dhënë gjithë ndihmën për përfundimin e këtij punimi.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	V
LISTA E TABELAVE	V
FJALORI I TERMAVE	VI
1. HYRJE.....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1 Risku i kredisë	2
2.1.1 Kriza e riskut të kredisë 2007-2009.....	3
2.1.2 Menaxhimi i kredive problematike.....	5
2.1.3 Si e menaxhon riskun e kredisë ProCredit Bank Kosovë?	6
2.2 Risku operacional	7
2.2.1 Përkufizimi i riskut operacional sipas Basel II.....	8
2.2.2 Kush janë shkaqet e Riskut Operacional	8
2.2.3 Çfarë është e nevojshme për të luftuar rreziqet operacionale?.....	9
2.2.4 Risku Operacional në Kosovë	9
2.2.5 Politikat e ProCredit Bankes në lidhje me riskun operacional	10
2.3 Risku i likuiditetit	11
2.3.1 Ku na qon mungesa e likuiditetit – ilustrim i krizës së likuiditetit.....	12
2.3.2 Risku i likuiditetit dhe kriza e 2008, spiralja rënies së likuiditetit	13
2.3.3 Ta kuptosh Riskun e Likuiditetit dhe ta drejtosh atë	14
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	17
3.1 Kriza financiare.....	17
3.1.1 Çfarë është një krizë financiare?	18
3.1.2 Si lind një krizë financiare?	20

4.	METODOLOGJIA	21
5.	PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	22
5.1	Ngjarjet në sistemin financiar	22
5.2	Palët kryesore në procesin e huadhënies nënstandarde - Kreditë hipotekore	23
6.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	26
7.	REFERENCAT	27

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rritja dramatike e kredive problematike.....	4
Figura 2. Spiralja e rënies së likuiditetit.....	14

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Bankat e falimentuara.....	5
--------------------------------------	---

FJALORI I TERMAVE

IBR - International Based Rating

AMA - Advanced Measurement Approaches

C.A.M.E.L.S. - (Capital adequacy, Asset quality, Management, Earnings, Liquidity, Sensitivity to market risk) ndjeshmëria e bankës ndaj riskut të tregut.

ALCO – Asset Liability Management Committee – Komiteti per menaxhimin e aktiv-pasiveve

SPE - Fondet “Trust Special Purpose Entities”

MBS - Mortgage-backed securities” të janë letra me vlerë të garantuara me pasuri të patundshme të vëna në hipotekë.

ARM - Kreditë hipotekore me norma interesi të korigjueshme Këto kredi (të quajtura “adjustable-rate mortgages”

1. HYRJE

Në biznesin e sotëm risku luan një rol kritik. Pothuajse në çdo vendim biznesi kërkohet që menaxherët dhe ekzekutivët të balancojnë riskun dhe kthimin. Menaxhimi efektiv i riskut të biznesit është esencial në suksesin e kompanisë. Në sistemin bankar menaxhimi i risqeve merr një rëndësi të vecantë, ku rregullatorët janë përgjegjës për mbrojtjen kundrejt dështimeve të sistemit bankar dhe të ekonomisë. Megjithëse bankat kanë shumë risqe të njëjta me bizneset e tjera, risqet kryesore që veçanërisht ndikojnë në bankat janë:

- Risku i Kredisë
- Risku Operacional
- Risku i Likuiditetit
- Risku i Tregut
- Risku i Normave të Interesit
- Risku i monedhës së huaj

Bankat duhet ti menaxhojnë me kujdes pasi një menaxhim jo efektiv i risqeve, mund të qojë shumë shpejt në dështimin e bankës. Në qoftëse një bankë perceptohet që është në pozicion të dobët financiar, depozituesit do të tërheqin fondet e tyre, bankat e tjera nuk do ta kreditojnë, nga ana tjetër banka vetë nuk do jetë në gjëndje të shesë letrat me vlerë të borxhit në tregjet financiare. Të gjitha këto do të përkeqësonin edhe më tepër situatën financiare të saj. Frika e dështimeve të bankave ishte një nga shkaqet kryesore të krizës së kredisë në vitet 2007-2009.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Risku i kredisë

Risku i kredisë është risku më i qartë i një banke nga natyra e veprimtarisë së saj, duke u mbështetur nga madhësia e humbjeve që i shkakton bankës, ai është risku kryesor. Ky risk përfshin riskun që kredimarrësi të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj bankës, sipas kushteve të vendosura bashkarisht në kontratën midis dy palëve (*Allen dhe Saunders, 2004*). Ky dështim qon në humbje të pjesëshme apo të plotë të shumave të dhëna hua. Megjithatë, risku i kredisë është edhe risku i përkeqësimit të pozicionit financiar të kredimarrësit. Përkeqësimi nuk është dështim në kuptimin e vërtetë të fjalës por rrit së tepërmi probabilitetin e dështimit. Sipas Baestanes (*Baestaens, 1999*) risku i kreditit në banka ndahet në *risk kredie nga portofoli bankar* dhe nga *risk kredie nga portofoli tregtar*.

Manaxhimi i dobët i riskut të portofolit ose mungesa e kujdesit ndaj ndryshimeve ekonomike apo rrethanave të tjera mund të çojnë në një përkeqësim të qëndrueshmërisë së kreditimit nga ana e bankave (*Altman, Resti, Sironi, 2005*). Arsyeja kryesore e manaxhimit të riskut të kreditit është maksimizimi i normës së kthimit të bankës, të rregulluar me riskun, duke mbajtur një ekspozim ndaj riskut të kreditit në parametra të pranueshëm. Bankat duhet gjithashtu të kenë parasysh lidhjet e riskut të kreditit me risqet e tjera (*Baesens, Setiono, Mues dhe Vanthienen, 2003*).

Bankat po përballen me riskun e kreditit gjithmonë e më tepër në instrumente financiarë të ndryshëm përveç kredive. Si të tillë mund të përmendim pranimet bankare, transaksionet ndërbankare, financimet tregtare, transaksionet e valutave të huaja, kontrata financiare të ardhshme, obligacione, si dhe në zgjerimin e angazhimeve, dorëzanive etj. Përderisa ekspozimi ndaj riskut të kreditit vazhdon të jetë burimi kryesor i problemeve në bankat në të gjithë botën, bankat dhe mbikëqyrësit e tyre duhet të jenë të aftë të nxjerrin mësimet e duhura nga eksperiencat e kaluara (*Boot, Thakor & Udell, 1987*).

Bankat tani duhet të jenë të vetëdijshme dhe të kenë dëshirë për të plotësuar në mënyrën e duhur nevojat e tyre për identifikimin, matjen, vëzhgimin dhe kontrollin e riskut të kreditit (*Berger, Hancock & Humphrey, 1993*).

Po kështu ato duhet të jenë të vendosura për të mbajtur kapitale të përshtatshme për tu mbrojtur ndaj këtij risku dhe të kompensohen në mënyrë të pranueshme për riskun e marrë përsipër. I rëndësishëm është inkurajimi i mbikëqyrësve për të promovuar praktika të qëndrueshme për manaxhimin e riskut të kreditit. Megjithëse parimet kryesore të manaxhimit efektiv të këtij risku janë të aplikueshme më qartë në biznesin e kredidhënies, ato duhet të aplikohen në të gjitha aktivitetet ku risku i kreditit është i pranishëm. Sipas Hand (*Hand, 2001*) drejtimet kryesore në të cilat bankat mund të mbështeten për të arritur rezultatet e duhura në manaxhimin e riskut të kreditit përfshijnë:

- krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për tu mbrojtur ndaj riskut të kreditit,
- ruajtjen e një veprimtarie të qëndrueshme kredidhënie, krijimin e një procesi të vazhdueshëm dhe të përshtatshëm të administrimit të kreditit,
- matjes së riskut në fjalë dhe monitorimit të tij dhe
- sigurimin e kontrolleve të përshtatshme dhe të mjaftueshme mbi riskun e kreditit.

2.1.1 Kriza e riskut të kredisë 2007-2009

Kultura e kredidhënies në SHBA ka ndryshuar shumë. Shndërrimi i aktiveve në letra me vlerë ndryshoi mënyrën se si bankat rritën biznesin e kredidhënies. Më parë bankat grumbullonin depozita për të financuar një kredi të re po kjo nuk ishte metoda më e shpejtë dhe efiçente për të fituar para. Bankat zbuluan se mund të rrisnin biznesin e tyre shumë shpejt nëqoftëse i drejtoheshin tregjeve të kapitalit sesa duke grumbulluar depozita. Diagrami i mëposhtëm tregon pjesën në % të kredive “Subprime”¹ ndaj total kredive të origjinuara si dhe % e amerikanëve që jetonin në shtëpitë e tyre kundrejt atyre që jetonin në shtëpi të marra me qera. Kreditë hipotekore “Subprime” përbënin më pak se 10% të të gjithë kredive hipotekore të dhëna deri më 2004 dhe gjatë 2005 - 2006 arritën në 20%. Këto kredi hipotekore, për individë me histori të keqe kredie, me vlerësimim jo të mjaftueshëm

¹ Subprime lending (near-prime, non-prime, or second-chance lending) në financë do të thotë të dhënit kredi me risk shumë të lartë

të kredisë, ishin të preferueshme nga investitorët në tregjet dytësore sepse ofronin norma shumë të larta kthimi.

Kështu gjithnjë e më shumë po rritjej përqindja e parave të grumbulluara nga shitja lirë e paketave të kredive “sub-prime”, në tregjet e kapitalit krahasuar me fondet e grumbulluara nga depozitat e klientëve. Bankat vepronin në mënyre të tillë sikur të kishin transferuar plotësisht riskun e tyre të kredisë. Ato i kushtonin vëmëndje sasisë së aktivitetit të kredidhënies sesa cilësisë së tij. Mbështetja në paketat e kredisë “sub-prime” dhe shitja e letrave me vlerë të siguruara nga këto kredi hipotekore në tregjet dytësore ishte bërthama e problemeve të tyre sepse ajo inkurajonte sjellje të shitjes grabitqare dhe standarte kredidhënie jo te forta apo të kujdesëshme.




Figura 1. Rritja dramatike e kredive problematike

Burimi: (Census Bureau, 2008)

Rritja dramatike e kredive problematike e si rrjedhim humbja e vlerës së Letrave me Vlerë të garantuara me këto lloj kredish qoi në kizë të kredisë, krizë të pasurive të patundshme dhe krizë financiare. Rezultati ishte rënie e madhe e kapitalit të shumë bankave në SHBA, falimentimi i një numri shumë të madh bankash dhe që pati pasoja negative për tregjet financiare në të gjithë globin. Gjithë tregjet u tkurrën në kredidhënie.

Pra që prej fillimit të krizës financiare në vitin 2007 numri i bankave të falimentuara në SHBA ka shkuar në 248, me total aktive prej \$615.2 miliard, total depozita \$ 430.1 miliard dhe kosto e FDIC ² \$69 miliard. Gjatë krizës financiare në SHBA falimentuan 3 banka në 2007, 25 banka në 2008, 140 banka në 2009 dhe 80 banka gjatë 2010 (Janar - Qershor 2010).

Viti	Nr. i bankave të falimentuara	Totali i aktiveve të bankave të falimentuara	Humbjet e FDIC'S DIF
2007	3	\$ 2,602,500,000.00	\$ 113,000,000.00
2008	25	\$ 373,588,780,000.00	\$ 15,708,200,000.00
2009	140	\$ 170,867,000,000.00	\$ 36,432,500,000.00
2010	80	\$ 68,171,000.00	\$ 16,786,600.00
Totali	248	\$ 615,229,280,000.00	\$ 69,040,300,00

Tabela 1. Bankat e falimentuara

Burimi: (*Federal Deposit Insurance Corporation*)

Pyetja që ngrihej herë pas here ishte:” Përse bankat ju dhanë kredi individëve, të cilët kurrë nuk do mund të kthenin kredinë mbrapa?” Përgjigja do të ishte:” Bankat nuk donin t’ia dinin për riskun e kredisë sepse dukej sikur ishte transferuar nga ato tek investitorët që investonin në letrat me vlerë të tyre”

2.1.2 Menaxhimi i kredive problematike

Objektivi kryesor i Menaxhimit të Riskut të Kredisë është të maksimizojë normën e kthimit të rregulluar nga risku duke mbajtur një nivel të pranueshëm të ekspozimit ndaj riskut të kredisë. Risku duhet të menaxhohet në nivel të “Debitorëve të Lidhur”³. Banka duhet të ketë politikë risku të qartë se si duhet të menaxhojë kreditë problematike. Komiteti i Bazelit ka identifikuar fushat në të cilat bankat duhet të sigurojnë transparencë të plotë dhe korrekte dhe ato janë: praktikat dhe politikat e kontabilitetit, menaxhimi i riskut të kredisë, cilësia e

² FDIC: Korporata e sigurimit të depozitave federale. Kur bankat dështojnë, FDIC caktohet si marrësi i tyre.

³ Connected obligor: Dy ose më shumë individë apo njësi ligjore formojnë një riks të vetëm 1) ku njeri ka kontroll mbi tjetrin në mënyrë direkte ose indirekte, ose 2) janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që veshirësitë financiare të njërit do të ketë ndikojnë tek gjithë të tjerët në vështirësi të pagesave të detyrimeve.

kredisë, fitimet. Bazel II ka vendosur rregulla se sa duhet të jetë kapitali i institucioneve financiare për të mbuluar humbjet potenciale. Për matjen e riskut të kredisë janë propozuar dy opsione. E para është mënyra tradicionale e standartizuar, e dyta është baza e vlerësimit të brendshëm IBR⁴, që do të sigurojë një strukturë të vetme nëpërmjet së cilës komponentët e riskut do të përkthehen në kërkesa minimale të kapitalit.

2.1.3 Si e menaxhon riskun e kredisë ProCredit Bank Kosovë?

Biznesi kryesor i Bankës ProCredit përbëhet nga huadhënia për klientët e bizneseve të vogla dhe të mesme si dhe klientëve privatë që dëshirojnë të kursejnë. Kështu, rreziku klasik kreditor është rreziku më i rëndësishëm me të cilin përballet banka. Prandaj, rreziku kreditor përbën pjesën më të madhe të rrezikut në kontekstin e llogaritjes së kapacitetit të bartjes së rrezikut.

Parimet themelore të bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor janë të vendosura në politikën e bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe vlerësimin e kolateralit. Këto politika janë në bazë të politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor dhe politikën e vlerësimit të kolateralit të grupit ProCredit, të cilat së bashku pasqyrojnë përvojën e grupit, të fituara gjatë aktiviteteve të suksesshme të huadhënies në ekonomitë në zhvillim dhe tranzicion.

Këto politika janë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës. Banka zbaton parime të caktuara për ta menaxhuar dhe ulur rrezikun kreditor. Këto parime përfshijnë analiza intensive të kapacitetit për borxhe të klientëve, shmangie e mbingarkimit të klientëve, monitorimin e ekspozimeve kreditore problematike, zbatimin e proceseve të dizajnuara me kujdes dhe dokumentuara, zbatimin e parimit “në katër sy”, ndërtimin e një marrëdhënie personale më afatgjate me klientin duke mbajtur kontakte të rregullta, si dhe investimi në punëtorë të trajnuar mirë dhe të motivuar.

⁴ Internal ratings based IRB approach, Management and Supervision (<http://www.bis.org/publ/bcbs144.htm>)

Për më tepër, diversifikimi i portfolios së kredive është një pjesë përbërëse e politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor. Ky diversifikim është në të gjithë sektorët e ekonomisë, grupet e klientëve, bizneset e vogla dhe të mesme si dhe individët privatë dhe institucionet. Një karakteristikë tjetër e qasjes së bankës është se ajo kërkon t'u japë klientëve produkte të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme. Edhe shkalla e lartë e diversifikimit, produktet dhe procedurat e thjeshta dhe transparente ulin profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës. Metoda të ndryshme të menaxhimit të rrezikut kreditor zbatohen kur banka ka të bëjë me kategori të ndryshme të klientëve dhe ekspozimeve kreditore.

Karakteristikat kryesore të proceseve të kreditimit për klientët e biznesit dhe privatë dhe për kategori të ndryshme të ekspozimeve kreditore janë: ndarja e detyrave për ekspozimet mesatare kreditore, proceset e standardizuara në huadhënie për klientët e bizneseve të vogla si dhe për klientët privatë, bazë e informatave për analizë kreditore për ekspozime të ndryshme kreditor, kriteret për vendimet e ekspozimeve kreditore dhe kërkesat e ndryshme të kolateralit në bazë të dokumentacionit, shumave dhe historisë kreditore të klientit.

2.2 Risku operacional

Risku operacional përkufizohet si risku i humbjes që rezulton nga dështime apo pamjaftushmëri të proceseve, njerëzve ose sistemeve, ose nga ngjarje të jashtme.

Ky përkufizim përfshin edhe riskun ligjor duke përfshirë atë strategjik dhe reputacional.

Është risk që vjen:

- mundësia që sistemi i informacionit është i mangët
- dështime teknologjike
- shkelje në kontrollin e brendshëm
- vjedhje
- katastrofa të paparashikuara ose
- probleme të tjera operacionale

Këto mund të rezultojnë me humbje të papritura ose probleme reputacionale. Risku operacional ekziston në të gjitha produktet dhe aktivitetet e Bankës.

2.2.1 Përkufizimi i riskut operacional sipas Basel II

Autoriteti dhe reputacioni i komitetit të Bazelit është në rang ndërkombëtar dhe nëpërmjet riskut operacional është fokusuar në sfidat praktike që lidhen me zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e rrezikut operacional dhe kornizën e matjes që përmbush kërkesat e Basel II, sidomos që kanë të bëjnë me matje të avancuara (AMA)⁵. Marrëveshja e re e Basel-it, e njohur gjithashtu si Basel II qartësisht e përkufizon Riskun Operacional si klasë të veçantë risku, i ndryshëm nga risku i kredisë apo risku i tregut dhe një kontribues i rëndësishëm në profilin e riskut të shërbimeve financiare të bankës.

Risku Operacional është ai risk që rrjedh nga zbatimi i funksioneve të biznesit të kompanisë. Si i tillë, ai është koncept shumë i gjerë duke përfshirë p.sh. risqet e mashtrimit, risqet ligjore, fizike ose risqet mjedisore, etj. Risku Operacional është një term që ka shumëllojshmëri kuptimesh prandaj, për qëllime të brendshme, bankat janë lejuar të miratojnë përkufizimet & vlerësimin e tyre të Riskut Operacional, duke inkurajuar përpjekjet për të përmirësuar dhe zhvilluar metodologjinë dhe mbledhjen e të dhënave në lidhje me menaxhimin e tij. Përkufizimi i përafërt i miratuar nga industria e menaxhimit të riskut e njeh riskun operacional si *"Risku i humbjeve direkte apo jo direkte që rezulton nga procese të brendshme të pa mjaftueshme ose të gabuara, njerezit dhe sistemet ose nja ngjarjete të jashtme"* (Patel & George, 2009). Ky përkufizim fokusohet në shkaqet e Riskut Operacional gjë kjo e përshtatshme si për menaxhimin e riskut dhe dhe për matjen e tij.

2.2.2 Kush janë shkaqet e Riskut Operacional

Menaxhimi i rrezikut operacional është bërë më kompleks gjatë disa viteve të fundit. Institucionet financiare, duke përdorur teknologjinë më të fundit (software), janë rritur shumë në madhësi, dhe janë të angazhuara në zhvillimin e multi - strukturuar të produkteve dhe shërbimeve. Kjo ka bërë operacionet e përgjithshme në këto institucione shumë të ndërlikuara dhe të vështira për tu trajtuar. Ky mjedis ka quar në një rritje të konsiderueshme

⁵ Advanced Measurement Approaches (AMA)

në disa lloje të rrezikut. Pra janë *faktoret e brendshëm dhe të jashtëm* që kanë kontribuar. Faktorët e brendshëm janë proceset e pamjaftueshme, dështimi i sistemeve ekzistuese, hardware joefikas dhe mos mirëmbajtja e servereve, pra të gjithë këta faktorë kanë kontribuar në operacionet bankare duke ndikuar negativisht. Fillimi i gabimeve manuale dhe atyre të komunikimit të gabuar ndodh si rezultat i një fuqie punëtore të madhe. Faktorët e jashtëm janë fatkeqësitë natyrore, trazirat politike, politikat e dobëta financiare të shtetit dhe mashttrimet penale kanë komplikuar edhe me tej rreziqet operacionale.

2.2.3 Çfarë është e nevojshme për të luftuar rreziqet operacionale?

- Mbrojtje e bankës nga të gjitha risqet e mundshme të kuantifikueshme
- Organizim më efficient dhe përdorim më efficient i burimeve të bankës
- Rritje e ndërgjegjësimit në lidhje me problematikat e riskut operacional në të gjitha nivelet e bankes.
- Zbatimi i një zgjidhje të fuqishme të automatizuar dhe zhvillimi i një politike të përcaktuar mirë të menaxhimit të rrezikut operacional e cila mund të identifikoj, monitoroj, vlerësoj dhe nëse jo të eliminoj, të reduktoj të gjitha rreziqet e mundshme.
- Kontrollat e forta të brendshme, incidentet dhe ndjekjet, profilizimi i rrezikut, përdorimi i automatizuar i alarm e-mailave dhe njoftimeve janë disa nga karakteristikat kryesore të një zgjidhje të shëndoshë administrimit të rrezikut operacional.

2.2.4 Risku Operacional në Kosovë

Politika Operacionale e Mbikëqyrjes të Bankës së Kosovës është dokument i cili përcakton kriteret e një mbikëqyrjeje të vazhdueshme të orientuar sipas riskut. Përcaktimi i profilit të riskut të bankës, si dhe vlerësimi sasior dhe cilësor i aktivitetit të saj, realizohen nëpërmjet inspektimeve në vend dhe analizave nga jashtë. Fokusi kryesor i tyre janë: risku i kredisë, risku i tregut, risku i likuiditetit, risku operacional si edhe ai ligjor, të cilët shoqërojnë

aspekte të ndryshme të aktivitetit të bankave. Profili i riskut të një banke do të vlerësohet kryesisht në bazë të sisteit CAMELS⁶ që përditësohet me rezultatet e monitorimit të vazhdueshëm të risqeve të aktiviteteve bankare. Përgjithësisht, cikli i mbikëqyrjes të një banke mund të ndryshojë pas një inspektimi të plotë në vend.

Bankat e Kosovës gjejnë se industria bankare duhet të rishikojë strategjitë e rritjes së aktivitetit bankar, duke harmonizuar më mirë nevojat për njerëz të kualifikuar si dhe ato financiare dhe teknologjike. Identifikimi dhe menaxhimi i Riskut Operacional mbetet një përparësi. Në terma më praktik, ky proces duhet të synojë në ndërtimin e mekanizmave të brendshëm që përvetësojnë krijimin e tepricave në drejtime të caktuara të veprimtarisë bankare dhe synojnë një diversifikim më të mirë të investimeve, si dhe mbështetjen e formave më të qëndrueshme të burimeve financiare. Të gjitha këto kërkojnë forcimin e sistemit të auditimit të brendshëm, nxitjen e strukturave për të vlerësuar dhe administruar risqet operacionale në përgjithësi, personel me ekspertizë bankare, si dhe vendosjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozituesit dhe klientët e tjerë të shërbimeve bankare përmes rritjes së transparencës.

2.2.5 Politikat e ProCredit Bankes në lidhje me riskun operacional

Në pajtueshmëri me principet e Basel II dhe rregullat përkatëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, rreziku operacional definohet si rreziku nga humbja si rezultat i proceseve jo-adekuate interne, rreziku nga njerëzit si dhe nga sistemet dhe/ose ngjarjet nga jashtë. Ky definim gjithashtu përfshinë edhe rrezikun ligjor. Banka menaxhon rrezikun operacional përmes politikave të dedikuara për këto rreziqe që përfshijnë Politikën e Menaxhimit të Rreziqeve Operacionale, atë për Parandalimin e Mashtrimeve, politikën e Sigurisë së Informatave, politikën e Nën-Kontraktimit, etj.

Menaxhimi i këtij rreziku është i mbështetur nga trajnime intensive të punonjësve në të gjitha nivelet, që ka dëshmuar të jetë efektiv në zvogëlimin dhe mënjanimin e rrezikut

⁶ Emri i shkurtuar CAMELS, i referohet treguesve të gjendjes së bankës, të cilët vlerësohen gjatë inspektimit dhe konkretisht: (Capital adequacy) mjaftueshmëria e kapitalit, - (Asset quality) cilësia e aktiveve, - (Management) administrimi, - (Earnings) të ardhurat, - (Liquidity) likuiditeti, - (Sensitivity to market risk) ndjeshmëria e bankës ndaj riskut të tregut.

operacional. Për të zvogëluar rrezikun operacional dhe atë të mashtrimit, të gjitha proceset kryesore të bankës janë të dokumentuara në mënyrë të duhur dhe përmbajnë mekanizmat e nevojshëm të kontrollit. Parimet “katër-sy” dhe të ndarjes së detyrave në mes departamenteve dhe funksioneve aplikohen kudo që është e nevojshme dhe e përshtatshme, në sistemet dhe proceset e bankës.

Vëmendje e madhe i kushtohet integritetit personal përmes zbatimit të kodit të mirësjelljes dhe programeve të trajnimit të dizajnuara me qëllim të promovimit të një kulture të transparencës dhe vetëdijes së rrezikut. Njohuritë mbi rrezikun operacional, të mashtrimit dhe të sigurisë së informacionit, si dhe kanalet për raportimin e ngjarjeve të këtyre rreziqeve, janë pjesë e trajnimeve të rregullta të stafit.

Banka përdor bazën e të dhënave të ngjarjeve të rrezikut përmes së cilës sigurohet që rreziqet operationale dhe rastet e mashtrimeve adresohen në mënyrë sistematike, duke i dokumentuar masat korrektuese dhe preventive. Si pjesë e kornizës së saj të menaxhimit të rrezikut operacional dhe të mashtrimit, banka bën vlerësime të rregullta të proceseve për identifikimin e rreziqeve dhe mungesave potenciale të kontrollit, që mund të zvogëlohen dhe kontrollohen me masa të duhura. Për më tepër, ndryshimet materiale në proceset dhe shërbimet e bankës, të reja apo aktuale, kalojnë përmes një procesi të rishikimit dhe aprovimit të rreziqeve. Gjithashtu, indikatorët kyç të rrezikut monitorohen nga rregullisht nga banka.

2.3 Risku i likuiditetit

Likuiditeti gjithmonë vjen i pari. Pa të një bankë nuk mund ti çelë dyert, me të një bankë ka kohë të zgjidhë problemet e saj bazë (*Donald Howard*). Sigurisht, nevoja e institucioneve financiare në përgjithësi dhe e bankave në veçanti, për likuiditet nuk është diçka e re. CEO I Citicorp ne vitin 1977 I cituar më lart, shpjegonte që përsa i përket prioritetit që duhet të kenë komponentët ne sistemin e retingut CAMEL, duhet te bëjmë rivers të këtij termi ne LEMAC. Duke vënë në radhë të parë likuiditetin, si më të rëndësishmin. Më poshtë po paraqesim disa përkufizime për likuiditetin dhe riskun e tij.

Sipas Bankës së Shqipërisë “Mungesë Likuiditeti” do të konsiderohet çdo situatë në të cilën banka: i. nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për ti realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga depozituesit ose kreditorët e tjerë, ose ii. nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta; Ndërsa “Rreziku i likuiditetit” është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit;

Së pari, ai është risku i mosfondësimit të fondeve me kosto normale. Ky risk buron nga perceptimi që kanë depozituesit dhe kreditorët e tjerë për emetuesin e borxhit (bankën) dhe politikën e tij të fondesimit. Ky perceptim lind nga sjellja e bankës në tregun e fondeve si dhe nga pozicioni i tij financiar. Së dyti, risku i likuiditetit është risku që tregu i një aktivi të jetë jo shumë likuid, pra të mos ketë cash të mjaftueshëm në treg. Së treti, risku i likuiditetit është risku që dhe vetë aktivi të mos jetë likuid, domethënë që të mos ketë aftësinë për tu shitur lehtësisht, megjithëse tregu vetë është likuid.

Një përkufizim tjetër lidhur me likuiditetin dhe riskun e tij jepet nga Lasse Heje Pedersen. Sipas tij ka dy lloje likuiditetesh: likuiditeti i tregut dhe likuiditeti i financimit. Një letër me vlerë ka likuiditet të mirë tregu, nëse ajo mund të tregtohet lehtësisht pra ka një diferencë të ulët çmim-blerje, çmim-shitje. Një bankë ose një investitor ka likuiditet të mirë financimi, nëse ai ka mundësi financiare të mjaftueshme, si nga kapitali i tij ashtu dhe nga kreditë e hipotekuara. Me këtë përkufizim të dhënë me lart, kuptimi i riskut të likuiditetit është i qartë: Risku i likuiditetit të tregut është risku që likuiditeti i tregut të keqësohet kur nevojitet tregtimi. Risku i likuiditetit të financimit është risku që palët të mos kenë mundësi të mbyllin pozicionet e tyre dhe janë të detyruara të tërhiqen.

2.3.1 Ku na qon mungesa e likuiditetit – ilustrim i krizës së likuiditetit.

Likuiditeti përgjithësisht varion në kohë dhe tregje të ndryshme. Të gjithë ishim dëshmitarë të krizës së likuiditetit me të cilën u përball bota financiare gjatë vitit 2008. Forma më ekstreme e likuiditetit të tregut është që të ketë vetëm kërkesë dhe të mungojë oferta për fonde, e cila ndodhi gjatë 2008 në disa tregje si ato të tregjeve për bono të konvertueshme dhe disa tipe letrash me vlerë të garantuara. Gjithashtu tregu u përball dhe me mungesë

likuiditeti financimi, për sa kohë bankat ishin me mungesë kapitali shkurtonin financimet në aktivitete që kërkonin kapitale të shumta apo shkurtuan financimet e shoqërive apo individëve. Të dyja format e likuiditetit janë të ndërlidhura dhe ndikojnë tek njëra-tjetra si një spirale, ku financimi i pakët qon në më pak aktivitet tregtar i cili nga ana e vet redukton likuiditetin e tregut duke qar në rritje të marzheve dhe duke forcuar menaxhimin e riskut, që në fund të fundit, keqëson financimin dhe kështu me radhë.

2.3.2 Risku i likuiditetit dhe kriza e 2008, spiralja rënies së likuiditetit

Sic dihet, shkak i krizës ishte “plasja e flluskave të sapunit: të çmimeve të ndërtesave, e shoqëruar me një ekspozim të lartë të institucioneve financiare. Kjo qoi në humbje të konsiderueshme financiare e shoqëruar me probleme të likuiditetit të financimit. Kjo filloi spiralen e likuiditetit. Ndërsa bilancet e bankave pësonin humbje duhej të merreshin masa.

Këto masa përfshinin:

- Shitja e aseteve;
- Grumbullimi i kesh-it;
- Shtrëngimi i menaxhimit të riskut.

Kjo krijoi stres në tregun e financimit ndërbanar, sepse çdokush po përpiqej të minimizonte ekspozimin e vet. Problemi i likuiditetit të financimit të bankave u përhap shumë shpejt. Të tjerë investitorë bankarë si psh: Fondet e investimeve të cilat kanë një levë të lartë financiare, u përballën me riskun e financimit pasi bankat po bëheshin shumë pak dashamirëse në kredidhënie. Si rrjedhojë ata rritën marzhin e çmimeve. Dhe në ekstrem situata përfundoi me falimentimin e Lehman Bank. Ky risk likuiditeti për financime qoi në likuidet të tregut me një variacion të gjerë të çmimeve shitje –blerje në tregje të ndryshme. Ky ilikuiditet i tregut së bashku me parashikimet për një risk më të madh të likuiditetit i frikësoi investitorët dhe çmimet ranë, vecanërisht për asetet ilikuide me marzhe të larta.

Grafiku më poshtë ilustron efektin spirale të likuiditetit të shpjeguar më lart. Dikush është pranë riskut, apo ka pësuar humbje dhe merr pozicion mbrojtës duke reduktuar pozicionin e tij, si rrjedhim:

- Kjo qon në ndryshime të çmimeve kundër tyre apo te tjerëve në të njejtin pozicion, duke qar në humbje të mëtejshme.
- Rrit ndryshueshmërinë e tregut, dhe redukton likuiditetin e tregut.
- Rriten marzhet dhe forcohen masat për mbikëqyrjen e riskut të likuiditetit.

Kjo e gjitha qon në probleme më të thella të riskut të likuiditetit të financimit; Kjo qon në pozicione të reduktuara dhe i gjithë cikli tre hapësh rifillon; E gjithë kjo vazhdon deri sa të arrihet një ekuilibër i ri.




Figura 2. Spirajla e rënies së likuiditetit

Burimi: (Garleanu & Pedersen, 2007 dhe Brunnermeier & Pedersen, 2008)

2.3.3 Ta kuptosh Riskun e Likuiditetit dhe ta drejtosh atë

Risku i likuiditetit është një nga risqet më pak të kuptuara dhe më të nënvlerësuara me të cilat pjesëmarrësit në tregun financiar përballen dhe kjo vjen për disa arsye:

- Risku i likuiditetit nuk ka tregues lehtësisht të përdorshëm.
- Në kushte normale tregu, problemet e likuiditetit nuk vihen re.

- Pavarësisht rekomandimeve, menaxhimi i riskut të likuiditetit është lënë jashtë llogaritjeve të mjaftueshmërisë së kapitalit, për shkak të mungesës së kontrollit dhe të rregullave.
- Menaxhimi i likuiditetit shpesh ngatërrohet me menaxhimin e riskut të likuiditetit.

Risku i tregut dhe i kredisë fokusohen tek asetet, ndërkohë që risku i likuiditetit buron sa tek asetet, po aq dhe tek detyrimet. *Risku i likuiditetit është gjithashtu i ndryshëm nga risku i tregut dhe i kredisë dhe rrjedhimisht duhet trajtuar ndryshe.* Analizat normale të risqeve të tregut dhe kredisë janë të pamjaftueshme, risku i likuiditetit mund të kuptohet vetëm nëpërmjet skenarëve. Matësit historik të likuiditetit shpesh janë të pavend, janë të domosdoshme perspektiva të reja. Për riskun e likuiditetit nuk mund të përdoren lehtësisht strategji mbrojtëse, ai thjesht mund të zbutet nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit. Për menaxhimin e riskut të likuiditetit bankat krijojnë strukturë organizative për këtë qëllim si dhe përcaktojnë qartë kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësisë të njësive/funksioneve organizative të bankës që realizojnë monitorimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit. Kjo njësi emërtohet ALCO⁷. Por si mund të menaxhohet risku i likuiditetit. Cilat janë hapat që duhet të ndiqen për të realizuar një menaxhim efikas të riskut? Sipas Michael R Guglielmo. Për të pasur një menaxhim të mirë të riskut të likuiditetit çdo strukturë duhet tu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Sa likuiditet kemi në dispozicion (operacional, rezerva, dhe emergjence)?
- Sa i suksesshëm është ky likuiditet dhe me çfarë kostoje?
- Sa likuiditet na nevojitet ne për veprimtarinë e përditshme në afat shkurtër dhe në afat gjatë?
- Nëse kushtet e tregut apo situatat ekonomike ndryshojnë si do të ndryshojnë kërkesat tona për likuiditet dhe disponueshmëria e Cash-it?
- Çfarë krizash dhe kushte ekonomike do të mund të ndikonin nevojat tona për cash dhe do të na ndërhyjnë në aksesin tonë tek rezervat apo tek burimet e emergjencës?
- A kemi një sistem të përshtatshëm lajmërimi që na mundëson aksione të mënjëhershme me shfaqjen e një problemi?

⁷ ALCO *asset-liability management committee* – Komiteti për menaxhimin e aktiv-pasiveve

- Çfarë aksione do të merrnin në rast të një krize likuiditeti dhe për sa kohë do të ndiqnim operacionet?
- A kemi proçese të përshtatëshme dhe sistemi kontrolli të tilla që të na mundësojnë që planet e përcaktuara do të ndiqen me sukses?

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Kriza financiare

Kriza është një ngjarje që ka sjellë apo pritet të sjellë një situatë jo stabile dhe të rrezikshme që ndikon tek individët, grupet, komuniteti apo edhe gjithë shoqëria. Ato sjellin ndikime negative në çështjet e sigurisë, ekonomike, politike, shoqërore, apo mjedisore, sidomos kur ndodhin papritmas, me një paralajmërim të vogël apo fare pa të.

Në përgjithësi, krizat karakterizohen si:

- Të papritura,
- Që krijojnë paqartësi,
- Shihen si kërcënim ndaj qëllimeve të rëndësishme.

Kriza financiare është një situatë në të cilën vlera e institucioneve financiare ose pasurive bie shumë shpejt. Kriza financiare është e lidhur shpesh me panik ose një situatë në bankat, në të cilën investitorët shesin pasuritë ose tërheqin paratë nga llogaritë e kursimeve duke pritur që vlera e këtyre pasurive do të bjerë nëse ato do të vazhdojnë të qëndrojnë në atë institucion financiar.

Kriza ekonomike është një situatë në të cilën ekonomia e një vendi përjeton një rënie të papritur e shkaktuar nga kriza financiare. Një ekonomi që përballet me krizë ekonomike më shumë gjasa do të sjellë një rënie të PBB (eng. GDP), një tkurrje të likuiditetit dhe rritje/rënie të çmimeve për shkak të inflacionit/deflacionit. Kriza ekonomike mund të marrë formën e një recesioni apo depresioni. Kriza ekonomike ndryshe quhet krizë e ekonomisë reale. Recesioni është periudhë e rënies së përgjithshme ekonomike, zakonisht përkufizohet si një tkurrje e PBB (eng. GDP) për gjashtë muaj (dy tremujorë rresht) apo më gjatë. Shënuar nga papunësia e lartë, paga të stagnuara, dhe të rënie në shitje me pakicë, etj., recesioni në përgjithësi nuk zgjatë më shumë se një vit dhe është shumë më i butë se depresioni.

Depresioni është pika më e ulët në një cikël të ekonomisë dhe karakterizohet nga

- rënia e fuqisë blerëse,

- papunësia masive,
- teprica e ofertës mbi kërkesën,
- rënie në çmime, ose çmimet në rritje më të ngadalëshme se zakonisht,
- pagat zvogëlohen, ose rriten me ngadalë se zakonisht, dhe
- mungesa e përgjithshme e besimit për të ardhmen.

Depresioni shkakton një rënie në të gjithë aktivitetin ekonomik, dhe mund të vazhdojnë për disa vite (siç ishte depresioni i madh). Ne Shtetet e Bashkuara, kriza financiare në fillim të viteve 1930 solli Depresionin e Madh, sikur që kriza e SHBA që filloi në vitin 2008 prodhoi një recesion të madh.

3.1.1 Çfarë është një krizë financiare?

Ka një literaturë të gjerë përse i përket krizave financiare të hartuar nga ekonomistë, teoricientë financiarë dhe analistë politikash. Çdo krizë financiare është unike në natyrën e saj. Gjithsesi një teori e përgjithshme mund të përdoret për të shpjeguar krizat financiare. Përkufizimet dhe këndvështrimet në lidhje me krizat financiare janë të larmishme. Po përmendim disa prej tyre:

“Një rreth vicioz humbjesh, reduktimi kapitali, shtrëngim krediti, likuidimesh të detyruara kompanish dhe shitje aktivesh me çmime shumë të ulëta do të çojnë në një cikël kaskadë humbjesh dhe shtrëngimi të mëtejshëm krediti”.

Nouriel Roubini, Shkurt 2008. Ishte ky njëri nga 12 etapat e skenarit të krizës financiare që parashikoi profesori i ekonomisë në Universitetin e New York-ut, Nouriel Roubini që në Shkurt të 2008, përpara se falimentimet e bujshme të institucioneve gjigante financiare të ndodhnin.

Në vitin 2008 bota hyri zyrtarisht në atë që nga të gjithë njihet si “Krizë e Kredive Hipotekore Nënstandarde” e njohur si “Subprime mortgage crisis”. Krizat financiare çorientojnë gjendjen financiare të një vendi, rrisin numrin e kompanive që falimentojnë, ulin prodhimin dhe shkaktojnë papunësi të madhe, pra, ngadalësojnë rritjen ekonomike të një vendi. Teori dhe politika të ndryshme janë zhvilluar me synim identifikimin e shkaqeve të krizave financiare dhe gjetjen e mënyrave për shmangien e tyre në të ardhmen. Por,

sërisht bota përjetoi kriza financiare që na bën të mendojmë se asnjë nga këto teori nuk është e mjaftueshme për të shmangur kriza të ardhshme financiare.

Sipas fjalorit të biznesit, një krizë financiare është një: “situatë në të cilën oferta për para tejkalohet nga kërkesa për para. Kjo nënkupton që likuiditeti “avullon” shpejt pasi paraja e disponueshme tërhiqet nga bankat, duke i detyruar bankat që ose të shesin investime të tjera për të kompensuar këtë rënie likuiditeti, ose të falimentojnë”.

Një nga përkufizimet më të mira për krizën financiare është dhënë nga R. Goldsmith në 1982, i cili i përcakton krizat financiare si: *“Një përkeqësim i mprehtë, i shpejtë, ultraciklik i të gjithë apo pjesës më të madhe të një grupi treguesish financiarë – normat afatshkurtra të interesit, çmimet e aktiveve, mungesë solvabiliteti dhe dështim i institucioneve financiare”.*

Një përcaktim më i afërt në kohë është dhënë nga Frederic Mishkin, i cili i përcaktoi krizat financiare nën këndvështrimin e problemeve me asimetrinë e informacionit:” Një krizë financiare është një çrregullim në tregjet financiare në të cilët problemet me *“adverse selection”* dhe *“moral hazard”* bëhen aq të mprehta sa që tregjet financiare bëhen të pa afta që të kanalizojnë me eficiencë fondet te ata që kanë oportunitete investimi më produktive”⁸. Pra, një krizë financiare është një përkeqësim i mprehtë i një sërë treguesish financiarë dhe ekonomike, si psh: rritja ekonomike, disbalancë mes ofertës dhe kërkesës për para, rënie e çmimeve të aktiveve, që mund të shoqërohet edhe me falimentime të institucioneve financiare si: bankat, fondet e përbashkëta dhe të investimeve, por edhe falimentim të institucioneve jofinanciare. Duke qenë se rritet numri i kompanive që falimentojnë, rritet edhe papunësia dhe shkohet drejt një ngadalësimi të rritjes ekonomike.

Problemet që lidhen me informacionin asimetrik mes huadhënësit dhe huamarrësit rriten dhe tregjet dështojnë. Studiues të tjerë të ekonomisë i lidhin krizat financiare me ciklet e biznesit. Kështu për shembull, Irving Fisher në “Teorinë Borxh-Deflacion të Depresioneve të Mëdha” (eng. The Debt-Deflation Theory of Great Depressions) të vitit 1937 flet për ciklet e biznesit. Sipas tij: *“Në boom-et e mëdha dhe në depresione, aktorët kryesorë “të këqinj” janë dy: niveli i tepërt i borxhit, si fillim, dhe deflacioni që vjen pas tij”.* Gjithashtu, Kindleberger argumenton se “krizat financiare janë të lidhura me kulmet e cikleve të

⁸ The National Bureau of Economic Research – NBER - “Anatomy of a Financial Crisis”, Dhjetor 1991

biznesit”. Minsky, duke vijuar teoritë e J.M. Keynes besonte se ekonomitë kapitaliste janë ciklike. Sipas tij, kapitalizmi është në një gjendje të përhershme çekuilibri, pasi asnjë nuk e di me siguri se ku ai po shkon, dhe kjo mungesë njohurie çon në një cikël boom-esh dhe dështimesh. Ndërsa ekonomia lëviz drejt kulmit të ciklit, struktura financiare bëhet më delikate pasi ngjitja drejt majës finançohej së tepërmi me borxh.

3.1.2 Si lind një krizë financiare?

Shpesh dëgjohet në qarqet ekonomike shprehja kontradiktore: “Të gjitha krizat financiare janë njësoj por asnjëra nuk i ngjan tjetrës”. Thuhet që krizat financiare ngjajnë me njera tjetrën sepse përgjatë historisë secila prej tyre i ka patur fillesat në një nga shkaqet e mëposhtme:

- Sulm spekulativ mbi kursin e këmbimit
- Panik financiar në sistemin bankar
- Kolaps i “fluskës së çmimit” për një aktiv të caktuar
- Rënie e menjëhershme në tregjet e aksioneve
- Falimentim i një qeverie

Megjithatë asnjëherë nuk ka qenë i mundur parashkimi dhe parandalimi i tyre, duke qenë se më vonë secila ka shfaqur një ndërthurje të veçantë të shumë prej faktorëve të mësipërm, duke u kthyer kështu në një krizë të shumëfishtë unike. Krizat financiare janë më të shpeshta nga sa mendohet dhe si çdo krizë sjellin gjithmonë humbje më të mëdha nga sa pritet.

4. METODOLOGJIA

Metodologjia e punimit është gërshetimi midis metodave sasiore dhe metodave cilësore të kërkimit. Punimi bazohet në përshkrimin e fakteve të ndryshme që lidhen me problematikën e kredive me probleme, duke analizuar teorikisht të gjithë elementët që ndikojnë në to. Në punim, një rëndësi të veçantë merr dhe analiza e të dhënave të cilat duke u krahasuar në periudha të ndryshme japin një tablo më të qartë të fenomeneve që përpiqen të shpjegojnë. Një peshë të madhe të punimit e zënë informacionet e përpunuara nga literatura ndërkombëtare mbi fushën bankare, raportet vjetore të bankave të ndryshme si dhe raportet vjetore të bankave të Kosovës. Në këtë punim informacionet janë marrë edhe nga bibliotekat elektronike të universiteteve të ndryshme si dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Burim tjetër dhe shumë i vlefshëm janë edhe materialet e marra nga kërkimet shkencore, revistat shkencore të dhëna këto kryesisht sekondare me metodën e deduksionit dhe induksionit si dhe metodën normative. Me metodën e dytë (sekondare), kemi studiuar duke hulumtuar, literaturë të botuar në gjuhën shqipe dhe angleze si dhe faqe të internetit ekskluzivisht të dizajnuara për këto probleme.

Çdo lloj analize e bërë mbi këtë literaturë të gjerë, përmban idetë dhe mendime të autorëve. Pa diskutim që punimi ka edhe kufizimet e veta, diktuar nga fakti se janë prekur ato çështje që janë konsideruar më të rëndësishmet. Jam e ndërgjegjshme se ka vend për zgjerime dhe përmirësime të mëtejshme, por e konsideroj këtë punim një hap solid në analizimin e njërës prej krizave më të rëndësishme në histori.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

5.1 Ngjarjet në sistemin financiar

Sa i përket ngjarjeve në sistemin financiar, mund të themi se në qendër të krizës më të madhe janë:

- rënia në çmimet e pasurive,
- dështimi i institucioneve financiare të shkaktuara nga
- josolvenca (*eng. Insolvency*) dhe kriza e likuiditetit apo kombinimi i këtyre të dyjave.

Rënia e çmimit të pasurive - kriza mund të jetë shkaktuar nga ulje të mëdha në çmimet e letrave me vlerë, pasurive të patundshme, ose pasuri të tjera. Shumë ekonomistë interpretojnë këto ulje si fundin e çmimeve pasurive “balon apo fluska” (*eng. Bubbles*).

Josolvenca - në një krizë tipike, uljet e çmimeve të pasurive janë të shoqëruara nga dështimet e institucioneve financiare. Një institucion mund të dështojë për shkak se ai bëhet i pa aftë të paguajë, që në fakt bën që pasuritë e tij të zvogëlohen dhe bien nën detyrimet e tij, dhe kapitali bëhet negativ. Një bankë komerciale mund të bëhet josolvente për shkak të humbjeve nga kreditë (*eng. Loan defaults*), rritjes së normat e interesit, dhe ngjarje të tjera. Kur një bankë bëhet josolvente, rregullatorët do ta detyrojnë që ajo të mbyllet.

Kriza e likuiditetit - edhe në qoftë se një institucion financiar është fillimisht solvent, ai mund të dështojë për shkak se nuk ka pasuri të mjaftueshme likuide për të bërë pagesat. Shembulli klasik i një krize likuiditeti është banka. Depozituesit që humbasin besimin në bankë, do të përpiqen për të tërhequr shumën të mëdha nga llogaritë e tyre, duke shterur rezervat e bankës. Krizat financiare kanë kosto direkte dhe indirekte. Kostot direkte përfshijnë humbjet e pronareve të mjeteve kur çmimet e pasurive bien. Ato përfshijnë gjithashtu humbjet nga dështimet e institucioneve financiare. Pronarët e një institucioni të dështuar humbasin kapitalin e tyre, dhe kreditorët e institucionit humbin fondet që kanë dhënë. Edhe pse kostot direkte mund të jenë të mëdha, kostot më të mëdha nga kriza

financiare vijnë nga efektet e tyre indirekte. Një krizë mund të vejë jashtë tërë zinxhirin e ngjarjeve që zhyt tërë ekonominë në recesion.

Kredidhënia dhe të shpenzuarit (eng. Lending and Spending) - një rënie në çmimet e pasurive mund të shkaktojë një rënie të forte në kërkesën agregate. Një arsye është se pronaret e mjeteve ndiejnë një humbje të pasurisë, e cila orienton për ta reduktuar konsumin e tyre. Rënia e çmimeve të pasurive tundra besimin e firmave dhe konsumatorëve, të cilët mund t'i interpretojnë ato si shenja se ekonomia e përgjithshme është në vështirësi. Pa qartësi për të ardhmen, i bënë të mos marrin vendime të mëdha rreth shpenzimeve apo investimeve, derisa gjërat të vendosen në rendin dhe vendin e duhur.

5.2 Palët kryesore në procesin e huadhënies nënstandarde - Kreditë hipotekore

Për të kuptuar më mirë zhvillimin e krizës financiare dhe rolin që kanë luajtur aktorë të ndryshëm në të, le të hedhim një vështrim mbi palët kryesore në procesin e huadhënies hipotekore dhe rolet e tyre, shkaqet e boom-it dhe krizës së kreditit, që më pas evoluoi në krizë financiare. Palët kryesore në procesin e huadhënies nënstandarde në Shtetet e Bashkuara përgjithësisht përfshinin një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis bankës huadhënëse dhe huamarrësit. Në dekadën e fundit, gjithsesi, ky proces evoluoi në një seri më komplekse transaksionesh dhe marrëdhëniesh mes shumë palëve. Pjesëmarrësit kryesorë dhe rolet e tyre në këtë proces diskutohen më poshtë:

Huamarrësit

Huamarrësit nënstandardë kanë karakteristika që i bëjnë ata më të ekspozuar ndaj dështimit në shlyerjen e kredisë. Disa nga këta faktorë përfshijnë: nivel të lartë borxh-të ardhura, historik krediti jo të mirë. Siç është përmendur edhe në paragrafin e mësipërm, janë pikërisht risku i lartë që bëjnë këta huamarrës i cili bënë që huadhënësit të ngarkojnë interesat dhe kosto të tjera më të larta për këta huamarrës.

Broker-at e kredive

Brokerat e kredive origjinojnë deri në 2/3 e kredive nënstandarde. Ata tregtojnë kreditë, vlerësojnë riskun e kreditit të huamarrësit dhe paraqesin aplikimet për kredi të huadhënies që financon kredinë.

Huadhënësit/Origjinuesite kredive

Huadhënësit janë njësitë që financojnë kreditë. Ato quhen shpesh edhe origjinues sepse janë ata që iniciojnë “securitization-in”⁹ e kredive. Huadhënësit i financojnë kreditë nëpërmjet një sërë mënyrash, duke përfshirë përdorimin e linjave të kreditit, shitjen e kredive dhe emetimin e letrave me vlerë të siguruara me hipotekë. Kontratat, në bazë të të cilave huadhënësit i shesin kreditë shpesh përfshijnë marrëveshje riblerjeje përmes së cilave huadhënësve mund t’u kërkohet të riblen kreditë nga blerësi në rast se normat e dështimit nga këta të fundit janë shumë të larta. Atyre u kërkohet të mbajnë rezerva të mjaftueshme për të përballuar kërkesat potenciale për riblerje.

Ofruesi i shërbimeve

Bëhet fjalë për sistemin e score-imit¹⁰ apo të përcaktimit të numrit të pikëve që cdo huamarrës arrin kur bëhet vlerësimi i tij bazuar në karakteristikat e tij (të ardhura, historik krediti etj). Ofruesi i shërbimeve të kredisë mbledh pagesat e kredive dhe gjobat për pagesa të vonuara, monitoron shumat e principalit dhe interesave të paguara, vepron si agjent për taksat dhe ekzekuton kolateralin në rast se huamarrësi dështon në shlyerjen e kredisë. Huadhënësit/origjinuesit shpesh vazhdojnë të kryejnë shërbimet e lidhura me kredinë kundrejt tarifave edhe pasi e kanë shitur apo titullarizuar kredinë.

Fondet “Trust Special Purpose Entities” (SPE)

Huadhënësit shpesh krijojnë truste dhe ia shesin të drejtat e tyre për pagesat e kredive trustit. Këto truste janë shpesh SPE dhe filiale të huadhënësit apo banka investimesh që nënshkruajnë (pranojnë) emetimin e letrave me vlerë të kolateralizuara nga huamarrësi (MBS)¹¹. SPE-të kontrollojnë hipotekat që garantojnë MBS-të. Struktura e tyre është e tillë që të izolojë investitorët nga detyrimet e huadhënësit.

Nënshkruesit

⁹“Securitization” në kontekstin e tregut hipotekor nënkuptonte grumbullimin e qindra apo mijëra kredive hipotekore dhe më pas shitjen e obligacioneve që mbështeteshin mbi këtë paketë kredish.

¹⁰ Bëhet fjalë për sistemin e score-imit apo të përcaktimit të numrit të pikëve që cdo huamarrës arrin kur bëhet vlerësimi i tij bazuar në karakteristikat e tij (të ardhura, historik krediti etj).

¹¹ Termi respektiv është: “Mortgage-backed securities” apo MBS. MBS-të janë letra me vlerë të garantuara me pasuri të patundshme të vëna në hipotekë.

Bankat e investimeve shpesh ofrojnë të dy llojet e shërbimeve: si ofrimin e shërbimeve të kredisë, dhe nënshkrimin e MBS-ve. Banka e investimeve përfiton interesa dhe tarifa mbi linjën e kreditit të huadhënësit, si dhe tarifën e nënshkrimit lidhur me emetimin e MBS-ve.

g) Agjensitë e Renditjes (“Rating”) MBS-të klasifikohen (renditen) nga një prej tre agjensive kryesore të “rating”-ut në Shtetet e Bashkuara: Standard & Poor’s, Moody’s ose Fitch Ratings. Këto agjensi analizojnë riskun e kreditit të kredive hipotekore që garantojnë MBS-të dhe vlerësojnë sesa të ngjarë ka që pagesat e kësteve të kredive të bëhen në kohën e duhur. Këto agjensi përfitojnë të ardhura nga tarifatat që marrin nga emetuesi i MBS-ve që kërkon vlerësimin e riskut nga ana e këtyre agjensive.

Investitorët

Fondet e përbashkëta, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve dhe investitorë të tjerë institucionalë janë investuesit në letrat më vlerë të kolateralizuara (MBS).

Çfarë e nxiti huadhënien nënstandarde?

- Rritja e çmimit të shtëpive
- Standarde huadhënieje jokërkuese (tolerante)
- Kreditë hipotekore me norma interesi të korigjueshme Këto kredi (të quajtura “adjustable-rate mortgages”- ARM)

Kur përmenden shkaktarët kryesorë, patjetër që përmendet instrumenti financiar unik i quajtur “Mortgage-backed security” (MBS) si një nga shkaktarët kryesorë.

6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Kriza globale e tregjeve financiare që fillimisht filloi si një krizë e kredive hipotekore në SHBA ku ka pasuar dhe është përhapur edhe në tregje të tjera, dhe institucione financiare. Kriza është një fenomen me ndikim të gjërë dhe të shumëllojshëm. Nevoja për shpjegimin e arsyeve që çuan në krizë financiare globale është mënyrë që të mund të parashikohen më mirë zhvillimet e mëvoshme të krizës. Pas një parashikimi më të mirë është edhe më e lehtë për të gjetur rrugëzgjdhjet më të përshtatshme.

Metodat e vlersimit të riskut të përdorura deri tani nuk kanë qënë më të mirat, më perfektet nisur nga situatat që u krijua. Risku faktik që shoqëron produktet e ndryshme financiare rezulton të jëtë më i lartë se ai i vlersuar. Rrjedhimisht norma e kthimit nga këto produkte financiare nuk është aq e lartë sa të kompesoj edhe riskun më të madh. Pra ekziston nevoja e përdorimit të metodave për vlersimin sa më real të risqeve të ndryshme duke marë parasysh edhe ndërveprimin e tyre. Një mësim tjetër që nxjerrim nga kjo krizë ka të bëjë me sistemet globale të bankave. Pra, mund të themi se evolucioni i tregjeve globale financiare kërkon një përmirësim të rregulloreve aktuale në mënyrë që t'ju përgjigjet rreziqeve të reja sistematike, për të siguruar stabilitetin financiar dhe për të kontribuar në qeverisjen globale financiare. Nga kjo krizë ato që dolën më të fituarat dhe të pa prekura nga kriza ishin pikërisht bankat universale (me diversifikim të lartë si të asetëve ashtu edhe të burimeve) dhe bankat tradicionale apo "primitive". Kjo përbën edhe një arsye se pse kjo krizë globale nuk preku bankat në Kosovë. Ato janë banka tradicionale dhe "primitive" për sa i përket llojshmërisë së produkteve. Ato i sigurojnë pjesën më të madhe të fondeve në tregun e brëndshëm dhe i investojnë pjesën më të madhe të tyre po në tregun e brëndshëm duke qënë kështu të izoluar nga tregjet globale dhe rrjedhimisht nga kriza globale.

Në Kosovë kreditë hipotekare nuk bazohen në vlerën e hipotekës si burim të kthimit të kredisë (*konsiderohen burim sekondar*), shuma e kredisë në raport me vlerën e hipotekës është maksimumi 80% dhe këstet e kredive janë mujore, që do të thotë se në rast se paguhet me rregull kredia, borxhi i mbetur reduktohet çdo muaj, kundrejt vlerës fikse të pronës hipotekë të nën-vlerësuar nga banka. Mirëpo, edhe në rast mospagese me kohë, kredia me probleme do të mund të identifikohet shumë shpejt, më së shumti pas 3 muajsh.

7. REFERENCAT

BQKR. (2012) *Rregullore mbi menaxhimin e rrezikut operacional*.

[Online] Qasshëm nga: http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Menaxhimi%20i%20Rrezikut%20Operacional.pdf

Bank for International Settlements. (2014) *Operational risk – Revisions to the simpler approaches*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.bis.org/publ/bcbs291.pdf>

CAREWeb – Enterprise Risk Management. (2014) *Operational Risks Management – Causes and Remedies*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.care-web.co.uk/blog/operational-risks-management-causes-and-remedies/>

Management and Supervision (2008) *Principles for Sound Liquidity Risk Management and Supervision*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.bis.org/publ/bcbs144.htm>

Shingjergji, A. (2014) *Ndikimi i faktoreve Makroekonomik dhe bankare ne nivelin e kreative me probleme ne sitemin banker shqiptar*. [Online] Qasshëm nga <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/10/Doktoratura-Ali-Shingjergji-Fakulteti-i-Ekonomise-Departamenti-i-Finances.pdf>

Operational Risk – Supervisory Guidelines for the Advanced Measurement Approaches (June 2011) [Online] Qasshëm nga: <http://www.bis.org/publ/bcbs196.pdf>

ProCredit Bank (2015) *Raporti Vjetor*. [Online] Qasshëm nga https://www.procreditbank-kos.com/repository/docs/AR-2015-al_942248.pdf

Moral Hazard (2013) *Economics*. [Online] Qasshëm nga <http://www.economicshelp.org/blog/105/economics/what-is-moral-hazard/>

Economics (2014) *Adverse selection explained*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.economicshelp.org/blog/glossary/adverse-selection/>

Pasotti, P. & Vercelli, A. (2015) *Kindleberger and Financial Crises*. [Online] Qasshëm nga: http://fessud.eu/wp-content/uploads/2015/01/Kindleberger-and-Financial-Crises-Fessud-final_Working-Paper-104.pdf

Vrioni, S. (2013) *Kriza ekonomike globale*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/KRIZA-EKONOMIKE-GLOBALE-Analiza-dhe-Implikime-.pdf>

Qarkaxhija, J. (2010) *Kriza globale financiare* [Online] Qasshëm nga: https://www.academia.edu/2210210/Kriza_globale_financiare

Bernanke, B. S. (2007) *The Subprime Mortgage Market*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.federalreserve.gov/newsevents/speech/bernanke20070517a.htm>

Bank for International Settlements (2008) *Principles for Sound Liquidity Risk Management and Supervision*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.bis.org/publ/bcbs144.htm>

Carmen, M. R. & Kenneth, S. R. (2008) *Is the 2007 US Sub-prime Financial Crisis So Different? An International Historical Comparison*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.nber.org/papers/w13761>

Frederic, S. M. and Stanley, G. E. (1998) *Financial Markets and Institutions*. [Online] Qasshëm nga: <http://trove.nla.gov.au/version/207914941>

Allen, L. & Saunders, A. (2004). *Incorporating systemic influences into risk measurements*. [Online] Qasshëm nga: <http://link.springer.com/journal/10693>

Altman, A. R. & Sironi, A. (2005) *The Link between Default and Recovery Rates*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.cfapubs.org/doi/abs/10.2469/dig.v36.n3.4214>

Baestaens, D. E. (1999). *Credit risk modeling strategies: the road to serfdom*. International Journal of Intelligent Systems in Accounting. [Online] Qasshëm nga: [http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/\(SICI\)1099-1174\(199912\)8:4%3C225::AID-ISAF162%3E3.0.CO;2-V/abstract](http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/(SICI)1099-1174(199912)8:4%3C225::AID-ISAF162%3E3.0.CO;2-V/abstract)

Hancock, D. & Humphrey, D. B. (1993) *Bank Efficiency Derived From the Profit Function*.

[Online] Qasshëm nga:

https://www.researchgate.net/publication/4963786_Bank_Efficiency_Derived_From_the_Profit_Function